



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:221002

Datë: 16.12.2023

Numri i dokumentit: 05078125

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.875/23

GJYKATA THEMELORE PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Shpresa Kërnya dhe bashkëpunëtoren profesionale Teuta Spahija në çështjen penale kundër të pandehurit A. D. nga Peja, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1605/23 të datës 17.10.2023 për shkak të veprës penale “Lëndim i lehtë trupor” nga neni 185 par.1, nën par.1.4 të KPRK-së, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 04.12.2023 në prezencë të prokurorit së shtetit Dorjan Juniku te pandehurit A. D. dhe të dëmtuarës E. D. me datë 04.12.2023 shpalli, ndërsa me datë 15.12.2023 përpiloj këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

A. D. i atësisë Q. dhe amësisë S., e vajzërisë T., i lindur me dt. .... në Pejë, ku edhe jeton në rr. “ B. I.”, nr.4, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion agjent i shitjes në B. SHPK,i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal ....., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Me datën 26.08.2023 rreth orës 18:00, në Pejë, pikërisht në shtëpinë e tij, ushtron dhunë psikike dhe fizike ndaj bashkëshortes së tij të dëmtuarës E. D., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje që kishin pas në mes veti, i pandehuri e gjuan me telefonin e tij me të cilin e godet të dëmtuarën në bërrylin e dorës së majtë, e më pas e kap për dore duke e hedhur në derën e dhomës, ku si pasoi e kësaj e dëmtuara pëson dyshim për thyerje në pjesën e poshtme të kockës së krahut të majtë dhe ndrydhje në bërrylin e majtë, me besueshmëri të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mprehtës (jo i mbrehte) të cilat si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore me pasoja të përhoshmë në shëndet.

- me çka ka kryer veprë penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1, nën par.1.4 të KPRK-së,

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074):

## GJYKON

Të pandehurit A. D. i shqipton:

I. DËNIM ME GJOBË në lartësi prej 300 (treqind) euro, të cilin detyrohet ta paguaj në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast që i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.

II. Obligohet i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 euro ndërsa në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

III. Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike eventuale, udhëzohet në kontest të rregullt civil-juridik.

## ARSYETIM

*A. Historiku i çështjes dhe vendimi ne lidhje me fajësinë;*

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 17.10.2023 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1605/23, kundër të pandehurit A. D. për shkak të veprës penale „Lëndim i lehtë trupor” nga neni 185 par.1, nën par.1.4 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 04.12.2023 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku dhe i pandehuri A. D., e dëmtuara E. D. dhe mbrojtësi i viktimave Luan Mehmeti.

Ku me pas prokurori i shtetit Dorjan Juniku fillimisht gjatë këtij shqyrtimit fillestar ka bërë përmisimin e dispozitivit të aktakuzës, i cili tani e tutje do të jetë si në vijim se: “ Me datën 26.08.2023 rreth orës 18:00, në Pejë, pikërisht në shtëpinë e tij, ushtron dhunë psikike dhe fizike ndaj bashkëshortes së tij të dëmtuarës E. D., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje që kishin pas në mes veti, i pandehuri e gjuan me telefonin e tij me të cilin e godet të dëmtuarën në bërrylin e dorës së majtë, e më pas e kap për dore duke e hedhur në derën e dhomës, ku si pasoi e kësaj e dëmtuara pëson dyshim për thyerje në pjesën e poshtme të kockës së krahut të majtë dhe ndrydhje në bërrylin e majtë, me besueshmëri të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mprehtës (jo i mbrehte) të cilat si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore me pasoja të përshoshmë në shëndet”.

Pasi që gjykata u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet e ftoi të njëjtin që të deklarohet në lidhje me akuzën, ku i pandehuri A. D. e pranoj në tërësi të gjitha veprimet që u përshkruan nga Prokurori.

Pas pranimi të fajësisë nga i pandehuri, gjykata e mori mendimin e prokurorit të shtetit, të pandehurit, të dëmtuarit dhe të mbrojtësit të viktimave, në lidhje me pranimin e fajësisë të cilët i propozuan gjykatës që të aprovohet pranimi i fajësisë.

Gjykata duke u bazuar ne nenin 242 par 2 dhe 6 të KPPRK-së vlerësoj se plotësohen kushtet ligjore për pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme

qe e mbështetin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike, andaj gjykata e aprovoj pranimin e fajësisë si te tillë.

*B) Vendimi ne lidhje me dënimin;*

Gjykata kur vendosi në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit të përcaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në nenet 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074), dhe atë duke pasur parasysh qëllimin e dënimit, rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese të nxjerra nga faktet e çështjes dhe duke aplikuar udhëzuesin për politikë ndëshkimore të Gjykatës Supreme të Kosovës, si në vijim.

1. Përcaktimi i dënimit ;

Kur vendosi në lidhje me dënimin kryesor gjykata u mbështet në nenin 40 par.1 pika 1.3 dhe nenin 42 par.1 si dispozita të përgjithshme dhe dispozitën e veçantë nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074) qe e përcakton veprën penale Lëndim i lehtë trupor dhe dënimin për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri.

Neni 185 par.1 nën par.1.4 i KPRK-së, përveç qe përcakton veprën penale e përcakton edhe minimumin dhe maksimumin e dënimit, qe është dënim me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet , ku pastaj gjykata duke u mbështetur në rrethanat e rastit konkret bëri individualizimin e dënimit për të pandehurin A. D. duke i shqiptuar të pandehurit dënim më gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

2. Vlerësimi i provave dhe argumenteve të palëve për rrethanat renduese dhe lehtësuese;

Duke pasur parasysh se në këtë çështje penale i pandehuri e pranoi fajësinë në fillim të shqyrtimit fillestar, gjykata nuk e pati mundësinë qe të administroj provat e propozuara në aktakuzë, megjithatë me rastin e vlerësimit të pranimin të fajësisë dhe pas shikimit të shkresave të lëndës nga provat e bashkëngjitura dhe deklaratimet e palëve në seancën e shqyrtimit fillestar gjykata arriti qe të nxjerr rrethanat të cilat janë përcaktuese për llojin dhe lartësinë e dënimit.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit

deklaroi “Duke marrë parasysh se i akuzuari A. D. e pranoi fajësinë konform kushteve ligjore të parapara me nenin 242 të KPPRK-së, me qenë se pranimin e fajësisë e beri vullnetarisht pa ndikim dhe në mbështetje në të gjitha faktet bë të cilat bazohet kjo aktakuzë, nga Gjykata kërkoi që të njëjtin ta shpallë fajtorë ta dënoi sipas ligjit si dhe ta obligoj në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në kuptim të dispozitivit ligjorë të nenit 70 par.2, pika 2.2 dhe 2.14 të Kodit të Procedurës të Republikës së Kosovës si rrethana renduese të vlerësoi shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale nga ana e të akuzuarit, nga se i njëjti duke mos u mjaftuar vetëm me një goditje me telefon të dëmtuarën në dorën i njëjti kishte vazhduar duke e manifestuar dhunën në atë mënyrë që e kishte kapur të njëjtën për dore dhe kishte hedhur më derë, po ashtu nga Gjykata kërkoi si rrethanë renduese të vlerësoi faktin se vepra penale nga ana e të akuzuarit është kryer në kuadër të marrëdhënies familjare e kjo nga fakti se me këtu të dëmtuarën janë në raport bashkëshortësie”.

Mbrojtësi i viktimave deklaroi “Meqenëse i akuzuari e pranoi fajësinë dhe siç e pamë ketë para gjykatës e dëmtuara deklaroi se i ka përmirësuar raportet tash e tutje i kanë marrëdhëniet e mira dhe se besoj se ndaj të njëjtës nuk do të përsëritet ndonjë veprim inkriminues, i propozoj gjykatës që ti merr për bazë deklarinimin e saj me rastin e matjes së dënimit”.

E dëmtuara E. D. deklaroi “Prej asaj dite e deri me sot na nuk kemi pas më telashe, jemi shumë mirë, ka ndodhur çka ka ndodhë dhe ne kemi tre fëmijë së bashku të cilët edhe i rrisim së bashku dhe unë pres që A. mos ti shqiptohet fare dënim, por prape se prape është gjykata ajo që vendosë, kjo është hera e parë dhe e fundit që kemi pas probleme”.

I pandehuri A. D. deklaroi “Kjo ka qenë thjesht e momentit, nuk ka ndodhur asnjëherë tjetër aso situata, më vie shumë keq që ka ndodhur ky rast sepse kjo është hera e parë, po behën 20 vite martesë dhe kurrë nuk kemi pas probleme”.

### 3. Konstatimi i rrethanave renduese dhe lehtësuese nga gjykata;

Pas analizimit të provave të bashkëngjitura lëndës dhe deklarimeve të palëve, gjykata si rrethanë renduese për të pandehurin A. D. gjeti faktin se vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare përkatësisht, i dëmtuara është bashkëshortja e të pandehurit.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë, ku për gjykatën pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit në fillim të seancës së shqyrtimit fillestar është një tregues i pendimit të të pandehurit dhe gatishmërisë së tij për të pranuar përgjegjësinë shoqërore për veprën e kryer.

Akceptimi i pranimit të fajësisë si rrethanë lehtësuese në këtë rast është i arsyeshëm, për shkak se i njëjti nuk bie në kundërshtim me rrethana të tjera të cilat do të mund ta zhvleftësonin vetë pranimin e fajësisë si shprehje e pendimit.

Shprehja e keqardhjes nga i pandehuri u mor si rrethanë lehtësuese me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, pasi që i pandehuri ka treguar shenja bindëse të keqardhjes, si dhe fakti që me të dëmtuarën janë pajtuar dhe ka qenë hera e parë që ka ndodhur një problem i tillë dhe marrëdhëniet e tyre janë çrregulluar.

Si përfundim gjykata vlerësoj rrethanat renduese dhe lehtësuese secilën veçanërisht dhe te gjitha së bashku, raportin dhe ndikimin e tyre në njëra tjetrën dhe në kontekst të qëllimit të dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe erdhi në përfundim se në aspektin përmbajtjesor rrethanat lehtësuese i mbi peshojnë rrethanat renduese e si rrjedhojë dënimi i shqiptuar të pandehurit A. D. është në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në nenin 69 dhe 70 dhe të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074).

Dënimin më gjobë gjykata e shqiptoj duke u bazuar në faktin se për veprë penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri ligjvënësi ka paraparë shqiptimin e dënimit me gjobë ose me burgim në mënyrë alternative, andaj gjykata duke u bazuar në nenin 43 par.1 dhe 2 të KPRK-së vendosi që të pandehurit t'i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, më bindjen se ky dënim, do të arrijnë në mënyrë të mjaftueshme të shprehin gjykimin shoqëror për veprën e kryer.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit A. D. është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale te ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Gjykata vendosi që e demtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike të udhëzohet në kontest të rregullt civil, e kjo duke u bazuar në nenin 462 par.2 të KPPRK-së.

Andaj, duke u mbështetur në faktet, provat dhe dispozitat ligjorë nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMLORE PEJË**

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.875/23, me datë 15.12.2023

Bashkëpunëtorja profesionale:

Teuta Spahija

Gjyqtari i vetëm gjykues:

Leon Përlaska

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.